



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes

UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA”

dhe

AGJENCISË PËR ZHVILLIM RAJONAL -PERËNDIM



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

i lidhur ndërmjet palëve

1. Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, të cilin e përfaqëson Prof. Dr. Armand Krasniqi, në cilësinë e Rektorit të këtij institucioni të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejmë Universiteti)

dhe

2. Agjencia per Zhvillim Rajonal – Perëndim, në Pejë, të cilën e përfaqëson Sokol Luta, në cilësinë e U.D. Drejtorit Ekzekutiv të kësaj organizate (në tekstin e mëtejmë AZHR-Perëndim).

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy entiteteve të sipershënuara. Të dyja entitetet do të kenë qëllime të përbashkëta në ofrimin e ekspertizës së ndërsjellët profesionale dhe promovimin e përbashkët të iniciativave të ndërlidhura me zhvillimit ekonomik dhe turizmin e qëndrueshëm, në veçanti në rajonin ekonomik perëndimorë të Kosovës.

Neni 2

Baza ligjore

Ky memorandum është i bazuar në tërësi mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat i kanë të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë, si dhe përkatësisht në Ligjin për Lirinë e Asociimit të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord që të bashkëpunojnë në fushat vijuese:

- i. Konceptimin, zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, me theks të veçantë në ato që ndërlidhen me ngritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale në këto fusha;
- ii. Mbështetjen e ndërsjellët profesionale në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve e të dyja entiteteve në fushat e lartcekura;
- iii. Shkëmbimi i përvojave, praktikave, ekspertizave dhe literaturës në fushat përkatëse;
- iv. Zhvillimin e programeve hulumtuese, projekteve kërkimore shkencore, dhe projekteve të tjera të cilat janë me interes për të dy entitetet;
- v. Organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, dhe bashkëpunime të tjera profesionale;



- vi. Organizimin e punës praktike për student dhe nëpunës tjerë pran të dyja entitetave sipas kërkesave përkatëse, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve.

Neni 5
Dispozitat përfundimtare

- i. Kjo marrëveshje do të shërbejë si kornizë për marrëveshjet specifike të cilat do të hartohen dhe lidhen për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen;
- ii. Kjo marrëveshja mund të ndryshohet ose plotësohet me pajimin e palëve;
- iii. Memorandumi nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplar origjinal dhe secila nga palët i mban nga 2 (dy) të tillë.

Neni 6
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga palët, dhe mbeten në fuqi deri në shfuqizimin e tij me një marrëveshje tjeter apo ndërprerje të marrëveshjes për bashkëpunim në pajtim me vullnetin e palëve.

Në emër të Universitetit “Haxhi Zeka” dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal –Perëndim, ne të poshtë nënshkruarit deklarojmë vullnetin për bashkëpunim në mes të dy entiteteve.

Në Pejë, me 01.03.2023

Për: UNIVERSITETIN “Haxhi Zeka”

Prof. Dr. Armand Krasniqi

Rektor i Universitetit “Haxhi Zeka”

Për: AZHR-Perëndim

Sokol Luta

U.D. Drejtore/Ekzekutiv

| | |
|---|-------------------------------------|
| REKTORATI | |
| Nr. / Br. / No. <u>844</u> | Nr. ifaq/ Br. str / No. pg <u>3</u> |
| Data / Datum / Date: <u>01.03.2023</u> Pejë / Peć | |